



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers*

**Takimi i Komisionit të Granteve**

**(minutat e takimit - përzgjedhja me short e anëtarëve të rinjë të katër komunave)**

Takimi është mbajtur në ndërtesën e Qeverisë, kati 11, me datë 14 Mars 2022, prej orës 10:20-11:00.

**Pjesëmarrësit:**

**z. Albin Kurti, Kryeministër i Republikës së Kosovës,**

z. Armend Muja, Kryetar i Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere, Kuvendi i Kosovës,

z. Elbert Krasniqi, Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal,

z. Arbërie Nagavci, Ministre e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit,

z. Ekrem Kastrati, Kryetar i Komunës së Malishevës,

z. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës së Lipjanit,

z. Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës së Obiliqit dhe

z. Dragan Petkovic, Kryetar i Komunës së Parteshit.

**Tema:**

Përzgjedhja me short e 4 anëtarëve të rinjë të Komisionit të Granteve nga niveli lokal për vitin 2022, në pajtim me nenin 32 të Ligjit të Financave të Pushtetit Lokal.

Fillimisht Kryeministri z. Albin Kurti, i përshëndeti anëtarët e Komisionit të Granteve, të thirrur për tërheqjen e shortit për përzgjedhjen e anëtarëve të rinjë nga radhët e kryetarëve të komunave sipas nenit 32 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal (LMFPL) të cilët shërbejnë gjatë vitit 2022 për të diskutuar dhe aprovuar financimin komunal për vitin 2023-2025 dhe çështje tjera të rëndësishme sa i përket nivelit komunal.

Komisioni i Granteve, sipas Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, është mekanizëm që përfshinë përfaqësues të institucioneve të ndryshme në nivelin qendror dhe lokal. Roli i Komisionit është të aprovojë grantin e përgjithshëm, si dhe grantet specifike për shëndetësi dhe arsim në nivelin lokal, gjë që reflekton mbi rëndësinë e punës së këtij Komisioni.

Parimet, kriteret dhe formulat e zbatuara për ndarjen e granteve qeveritare për financimin e komunave bazohen në këtë ligj dhe tabelën e projeksioneve makro-fiskale, e cila përgatitet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Vlen të theksohet se Komisioni i Granteve do të takohet sërish për të diskutuar dhe aprovuar financimin komunal për vitin 2023, dhe orientimet për vitet 2024-2025, bazuar në prioritetet strategjike të Qeverisë në fushën e marrëdhënieve fiskale ndërqeveritare.

Qëllimi i këtij takimi ishte përzgjedhja e anëtarëve të Komisionit të Granteve nga Komunitatet për vitin 2022.

Zgjedhja e kryetarëve të komunave bëhet përmes dy shorteve të veçanta, të cilat mbahen në bazë vjetore nga Komisioni i Granteve.

Në njërin short përfshihen vetëm emrat e komunave shumicë ndërsa në tjetrin vetëm emrat e komunave pakicë.

Emrat e tri komunave zgjedhën në shortin e parë dhe emri i një komune pakicë zgjidhet në shortin e dytë.

Procesi i përzgjedhjes u zhvillua në dy faza:

- Në fazën e parë u zgjedhën komuna Prishtinë, Gjilan dhe Viti, ndërsa
- Në fazën e dytë u zgjedh komuna e Artanës.

**Komunitatet Prishtinë, Gjilan, Viti dhe Artanë do të shërbejnë si anëtarë të Komisionit të Granteve për vitin 2022 për të diskutuar dhe aprovuar financimin komunal për vitin 2023-2025 dhe çështje tjera të rëndësishme për buxhetin komunal.**

Përgatiti:

Sekretaria e Komisionit të Granteve  
Ministria e Financave